



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 806/5 Prot

Tiranë, më 24. 5.2022

VENDIM

Nr. 15, datë 24. 5.2022

PËR

RRËZIMIN E ANKESËS

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesja, znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 806 Prot., datë 15.04.2022, (vijuar me emailin datë 11.05.2022), me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Ankuesja, me anë të kërkesës datë 25.03.2022, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion, informacioni/dokumentacioni lidhur me çështjen e Delimitimit të Kufirit Detar të Shqipërisë me Greqinë, si më poshtë:

1. Në cilën fazë ndodhet aktualisht çështja e delimitimit të kufirit detar me Greqinë?
2. Në cilën fushë është avancuar dhe cilat janë pengesat për të vijuar më tej?
3. Si është përzgjedhur studio ligjore “Omnia Strategy LLP” për këshillimin e palës shqiptare në çështjen e Delimitimit të Kufirit Detar me Greqinë, për t’u përfaqësuar në Gjykatën e Arbitrazhit në Hagë?
4. Sa i ka kushtuar shtetit shqiptar kontrata e lidhur me këtë firmë dhe cilat kritere janë marrë parasysh për përzgjedhjen e saj?

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesja ka paraqitur ankim pranë Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Zyra e Komisionerit pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, në përputhje me përcaktimet e nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur”*, Komisioneri, me shkresën nr. 806/1 Prot., datë 22.04.2022 ka kërkuar nga Autoriteti Publik informacion lidhur me trajtimin apo procedurën e ndjekur në lidhje me kërkesën për informacion.

Koordinatorja për të drejtën e informimit pranë Autoritetit Publik, nëpërmjet e-mail-it datë 06.05.2022, ka bërë me dije se: *“...Të dy qeveritë janë deklaruar se synojnë që të zgjidhin përmes një kompromisi çështjen e delimitimit të zonave të tyre detare nga një palë e tretë gjyqësore, konkretisht Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë. Qeveria shqiptare është duke ndërmarrë hapat përgatitorë teknike për këtë proces. Në bazë të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën për informim”, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme nuk mund të vendosë në dispozicion informacion të klasifikuar në lidhje me konsulencën e nevojshme teknike dhe ligjore për këtë proces përgatitor, pasi nuk ekziston asnjë mundësi që ky informacion të deklasifikohet në këtë fazë. Në të kundërt Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme jo vetëm do të cenonte legjislacionin në fuqi por dhe pozitën e palës shqiptare në këtë proces delikat për interesat e vendit”*.

Me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave, që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, me Urdhrin nr. 68, datë 04.05.2022, Komisioneri vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik duke filluar nga data 09.05.2022.

Gjatë inspektimit të ushtruar, përfaqësuesja e Autoritetit Publik sqaroi se: *“Në paragrafin e parë të përgjigjes Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është shprehur brenda fushës së saj të kompetencës duke shpërndarë informacionin që është bërë publik se: “Të dy qeveritë janë deklaruar se synojnë që të zgjidhin përmes një kompromisi çështjen e delimitimit të zonave të tyre detare nga një palë e tretë gjyqësore, konkretisht Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë”. Qeveria shqiptare është duke ndërmarrë hapat përgatitorë teknike për këtë proces. Pyetjet që ka shtruar gazetarja lidhur me fazën në të cilën ndodhen negociatat apo hapat teknikë që janë ndërmarrë përfshirë këtu edhe kontraktimin e konsulentëve në këtë fazë të procesit janë të lidhura me dokumente të klasifikuara të cilat janë hartuar dhe administrohen në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar. Konkretisht në përgjigjen e kthyer paragrafi i dytë organi administrativ Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është shprehur se nuk mund të japë informacione të klasifikuara të cilat në këtë fazë të procesit të marrëdhënieve dypalëshe nuk mund të deklasifikohen. Ky qëndrim i mbajtur nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme është*

në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” pika 2, germa “a” parashikon që:

“2. E drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mëposhtëm:

a) sigurinë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;

...

ndërsa në pikën 5 të dispozitës së sipërcituar ky ligj parashikon ;

... 5. E drejta e informimit nuk refuzohet automatikisht kur informacioni i kërkuar gjendet në dokumente të klasifikuara “sekret shtetëror”. Në këtë rast, autoriteti publik, të cilit i është dërguar kërkesa për informim, fillon menjëherë procedurën e rishikimit të klasifikimit pranë autoritetit publik që ka urdhëruar klasifikimin, sipas ligjit nr.8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar. Autoriteti publik njofton menjëherë kërkesin për fillimin e procedurës për rishikimin e klasifikimit, sipas ligjit, dhe vendos shtyrjen e afatit për dhënien e informacionit brenda 30 ditëve pune. Në çdo rast, vendimi për trajtimin ose jo të kërkesës për informim merret dhe arsyetohet në bazë të kritereve të këtij neni.”

Gjithashtu, përgjigja e kthyer gazetares është në përputhje të plotë me parashikimet e nenit 17 pika 2 germa “ë” në të cilin ligjvënësi ka parashikuar që “e drejta e informimit kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj interesave të mbarëvajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare ose ndërqeveritare”.

Në vijim, koordinatorja për të drejtën e informimit, me e-mail-in datë 11.05.2022, ka kthyer përgjigje për sa më sipër, duke sqaruar ndër të tjera se: “...në bazë të ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar “sekret shtetëror”, të ndryshuar, dhe VKM-së nr. 662, datë 15.11.2017 “Për miratimin e rregullores për deklasifikimin dhe zhvlerësimin e informacionit të klasifikuar “sekret shtetëror”, Komisioni për Deklasifikimin, Zhvlerësimin e Informacionit të Klasifikuar “sekret shtetëror” (KDZH), ka marrë në shqyrtim kërkesën dhe ka vendosur se nuk jemi në kushtet që dokumentet të deklasifikohen. Sa më sipër të gjitha pyetjet e parashtruara lidhen me dokumente të klasifikuara të hartuara dhe administruara në përputhje me ligjin dhe që në këtë fazë të procesit nuk mund të deklasifikohen”.

Nga shqyrtimi i çështjes konstatohet se objekti i kërkesës ka të bëjë me informacion, i cili rregullohet dhe i nënshtrohet dispozitave të ligjit nr. 8457, datë 11.02.1999 “Për Informacionin e Klasifikuar Sekret Shtetëror” i ndryshuar.

Në këto kushte, pavarësisht se në parim informacioni i kërkuar përbën informacion publik në kuptim të pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, në rastin konkret publikimi i tij kufizohet në përputhje me shkronjën a) të pikës 2 të nenit 17, të ligjit të sipërcituar.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjën c) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 ‘Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’ i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Rrëzimin e ankesës nr. 806 Prot., datë 15.04.2022 të znj. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
3. Ky vendim u shpall sot në datë 24.5.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

